

1.3.1	Plantain leaf
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



FLETUDHËZIM: INFORMATA PËR PËRDORUESIN

Herbion® shurup delli ekstrakt delli dhe mullage/acid askorbik **për lehtësim të kollës**

Lexojeni këtë fletudhëzim të tërin me kujdes sepse përmban informata të rëndësishme për ju.

Ky bar është në dispozicion pa recetë. Megjithatë, ju duhet të merrni Herbion shurup delli me kujdes për të përfituar rezultatet më të mira prej tij.

- Ruajeni këtë fletudhëzim. Mund t'ju duhet ta lexoni përsëri.
- Nëse keni pyetje ose kërkon këshilla të tjera, drejtojeni farmacistit.
- Duhet t'a kontaktoni mjekun nëse simptomat ju përkeqësohen ose nuk përmirësohen pas 5-7 ditësh.
- Nëse cilido nga efektet anësore përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi tregojini mjekut ose farmacistit.

Në këtë fletudhëzim:

1. Çka është Herbion shurup delli dhe për se përdoret
2. Para se të merrni Herbion shurup delli
3. Si të merrni Herbion shurup delli
4. Efektet e mundshme anësore
5. Si ta ruani Herbion shurup delli
6. Informata shtesë

1. ÇKA ËSHTË HERBION SHURUP DELLI DHE PËR SE PËRDORET

Herbion shurup delli përmban një ekstrakt të përzierjes së gjetheve (gjethe të ngushta) delli dhe lules së mullagës, dhe vitaminë C. Mucilagje, substanca aktive e të dy barnave herbale formon një shtresë të hollë mbi mukozën e gojës dhe të fytit duke e mbrojtur atë nga stimulimet që nxisin kollën.

Herbion shurup delli është një bar herbal që rekomandohet për kollë të thatë, irrituese, që shoqëron sëmundjet e sipërme të frymëmarrjes.

Herbion shurup delli është bar herbal tradicional përdorimi i të cilit për indikimet e mësipërme bazohet vetëm në përvojën afatgjate.

2. PARA SE TË MERRNI HERBION SHURUP DELLI

Mos merrni Herbion shurup delli

- nëse jeni të mbindjeshëm në ekstratin e gjetes së dellit, ekstraktin e lulës së mullagës, vitamin C ose në ndonjë prej përbërësve të këtij bari (listuar në seksionin 6).

Paralajmërimet dhe masat paraprake

Bisedoni me mjekun tuaj ose farmacistin para se të filloni të përdorni Herbion shurup delli.

Tregoni kujdes të veçantë me Herbion shurup delli

- Nëse ju keni sëmundje të zgjatur të frymëmarrjes, vështirësi në frymëmarrje, temperaturë, kollë kronike ose ngjirje të zërit, ose gjak në pështymë, ju duhet të shihni mjekun tuaj menjëherë;

1.3.1	Plantain leaf
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



- Nëse ju jeni një pacient diabetik, ju duhet të jeni të vetëdijshëm se shurupi përmban saharozë dhe nuk rekomandohet për ju;
- Nëse nuk ju ndalet kollitja pas 5-7 ditë të marrjes së shurupit, këshillohuni me mjekun tuaj.

Fëmijët

- Shurupi nuk rekomandohet për fëmijët nën moshën 4 vjeçare pa u këshilluar së pari me mjekun.

Marrja e barnave tjera

Ju lutem tregojini mjekut ose farmacistit tuaj nëse jeni duke marrë ose keni marrë barna të tjera kohëve të fundit, duke përfshirë barna që merren pa recetën e mjekut.

Nuk ka të dhëna se bari ndikon në efektin e barnave tjerë.

Marrja e Herbion shurup delli me ushqim dhe pije

Nuk ka raportime të interaksioneve me ushqim.

Rekomandohet që gjatë marrjes së shurupit të pihet çaji ose pije të tjera të ngrohta.

Shtatzënia dhe gjdhënia

Kërkojini këshillë mjekut ose farmacistit para përdorimit të barnave.

Nëse jeni shtatzënë, mendoni se jeni shtatzënë ose planifikoni të keni foshnje, bisedoni me mjekun tuaj ose farmacistin para se të merrni këtë bar.

Meqë nuk ka të dhëna të mjaftueshme mbi sigurinë e përdorimit gjatë shtatzënisë dhe ushqyerjes me gji, nuk rekomandohet përdorimi i Herbion shurupi delli gjatë kësaj periudhe. Nuk ka informacione të disponueshme për efektet ndaj fertilitetit.

Ngasja dhe përdorimi i makinerive

Nuk ka të dhëna se bari ndikon në aftësinë për të drejtuar automjete ose për të përdorur makineri.

Informata të rëndësishme për disa nga përbërësit e Herbion shurup delli

Herbion shurup delli përmban saharozë, metil parahidroksibenzoat (E218) dhe natrium.

Nëse ju nuk toleroni disa sheqerna (ju keni një intolerancë ndaj disa sheqernave), kontaktoni mjekun tuaj para se të merrni këtë bar.

Doza individuale e rekomanduar për të rriturit (2 lugë dozuese) përmban 8 g saharozë. Këtë duhet patur parasysh te pacientët me diabetes mellitus.

Metil parahidroksibenzoat mund të shkaktojë reaksione alergjike (janë të mundshme reaksionet e vonuara).

Ky bar përmban më pak se 1 mmol natrium (23 mg) për dozë, respektivisht në esencë është "pa natrium".

3. SI TË MERRET HERBION SHURUP DELLI

Gjithmonë merrni Herbion shurup delli saktësisht siç ju ka udhëzuar mjeku. Duhet të konsultoheni me mjekun ose farmacistin nëse nuk jeni të sigurt. Doza e zakonshme është:

Përdorimi te fëmijët dhe të rriturit

Doza e rekomanduar për të rriturit dhe fëmijët mbi 14 vjeç është 2 lugë dozuese të shurupit 3 deri në 5 herë në ditë. Fëmijët nga 7 deri në 14 vjeç duhet të marrin 1 deri në 2 lugë dozuese të shurupit 3 herë në ditë, dhe fëmijët nga 4 deri në 7 vjeç 1 lugë dozuese të shurupit 3 herë në ditë.

Shurupi nuk rekomandohet për përdorim te fëmijët nën moshën 4 vjet pa konsultim paraprak me mjekun.

1.3.1	Plantain leaf
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



Nuk duhet të hani ose pini menjëherë pas marrjes së barit për shkak se ushqimi dhe pijet mund të përshpejtojnë largimin e barit nga mukoza e membranës së gojës dhe fytit.

Nëse simptomet nuk largohen pas 1 jave, bisedoni me mjekun apo farmacistin.

Tundeni shishen para përdorimit. Mbylleni mirë shishen pas përdorimit.

Rekomandohet që gjatë marrjes së shurupit të pini shumë çaj ose pije të tjera të ngrohta.

Nëse merrni Herbion shurup delli më shumë se ç'duhet

Mos merrni doza më të larta se ato që ju janë përshkruar.

Nëse keni marrë një mbidozë, këshillohuni menjëherë me mjekun.

Nëse harroni të merrni Herbion shurup delli

Mos merrni dozë të dyfishtë për ta kompensuar dozën e harruar.

Merreni dozën e harruar sa më shpejt të jetë e mundur vetëm nëse është tashmë koha për të marrë dozën tjetër të radhës. Në këtë rast, lëreni dozën e harruar.

Nëse e ndërprisni marrjen e Herbion shurup delli

Në rast se keni pyetje të mëtejme lidhur me përdorimin e këtij produkti, drejtoheni mjekut ose farmacistit.

4. EFEKTET ANËSORE TË MUNDSHME

Sikurse të gjitha barnat, Herbion shurup delli mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo të gjithë paraqiten ato.

Çrregullime të sistemit imun

Rrallë (mund të ndikojë te 1 në 1,000 persona): reaksione të mbindjeshmërisë në përbërësit e barit

Nëse ndodhë mbindjeshmëria, ndërpreni marrjen e shurupit dhe këshillohuni me mjekun ose farmacistin.

Paraqitja e efekteve anësore

Nëse ju paraqitet çfarëdo efekti anësor, duhet që të lajmëroni mjekun ose farmacistin. Kjo përfshin çdo efekt anësor që nuk është dhënë në këtë fletudhëzim. Efektet anësore mund të paraqiten drejtëpërsëdrejti nëpërmjet sistemit nacional të raportimit. Me paraqitjen e efekteve anësore mund të ndihmoni në vlerësimin e sigurisë së këtij bari.

Nëse ndonjë efekt anësor përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi njoftojeni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TË RUHET HERBION SHURUP DELLI

Mbajeni larg syve dhe duarve të fëmijëve.

Mos e përdorni Herbion shurup delli pas datës së skadimit e cila është e shënuar në karton pas EXP. Data e skadimit i referohet ditës së fundit të atij muaji.

1.3.1	Plantain leaf
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo



Para hapjes së shishes:

Ky bar nuk kërkon ndonjë kusht special për ruajtje.

Pas hapjes së shishes:

Të ruhet në temperaturë deri në 25°C. Shurupi duhet të përdoret brenda 3 muajve pas hapjes së shishes.

Barnat nuk duhet të hidhen nëpërmjet kanalizimit ose mbeturinave të shtëpisë. Pyeteni farmacistin se si t'i hidhni barnat që nuk ju duhen më. Këto masa do të ndihmojnë për ta ruajtur mjedisin.

6. INFORMATA SHITESË

Çka përmban Herbion shurup delli

Substancat aktive është: ekstrakt të lëngshëm të gjetheve të dellit, ekstrakt të lëngshëm të luleve të mullagës dhe vitamin C.

5 ml (1 lugë dozuese) shurup përmban:

- 2,5 g të ekstraktit të lëngshëm të përzierjes së gjethe delli (*Plantago lanceolata* L. s.l., *folium*) dhe lules së mullagës (*Malva sylvestris* L., *flos*), që është ekuivalent me 0,25 g gjethe delli dhe 0,25 g lule mullage.

Tretësi ekstraktues: ujë.

- 65 mg të acidit askorbik (vitamin C) në formë të 73,12 mg askorbat natriumi.

Përbërësit e tjerë janë: saharozë, metil parahidroksibenzoati (E218), aromë e vajit të portokallit.

Si duket Herbion shurup delli dhe përbërja e paketimit

Shurupi është ngjyrë kafe në kafe të kuqërremtë dhe ka shije dhe aromë karakteristike.

Shurupi është në dispozicion në kuti me 150 ml shurup në një shishe së bashku me një lugë dozuese.

Mënyra e dhënies së barit

Bari jepet pa recetë të mjekut.

Mbajtësi i Autorizimit për Marketing dhe Prodhuesi

KRKA, d.d., Novo mesto, Šmarješka cesta 6, 8501 Novo mesto, Slloveni

tel: +386 7 331 28 84,

fax: +386 7 332 27 42

www.krka.si

Ky fletudhëzim së fundmi është miratuar në

06/2024.